



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## **STUDIM VLERËSUES**

**MBI**

# **NGARKESËN E PUNËS NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT**

(Miratuar me vendimin nr. 23, datë 04.03.2015 të KLD-së)

**Përmbajtja**

|   |    |
|---|----|
| Akronime .....  | 3  |
| Hyrje.....  | 4  |
| 1. KRIJIMI I GJYKATAVE ADMINISTRATIVE .....   | 5  |
| 1.1. Kuadri ligjor .....  | 5  |
| 1.2. Kuadri organizativ .....   | 7  |
| 1.2.1. Numri i gjyqtarëve.....  | 7  |
| 1.2.2. Numri i administratës gjyqësore.....   | 12 |
| 2. SITUATA AKTUALE .....  | 15 |
| 2.1. Vlerësimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.....                                      | 15 |
| 2.2. Ngarkesa e gjykatave administrative .....  | 16 |
| 2.3. Vakancat në numrin e gjyqtarëve .....  | 20 |
| 2.4. Ndihmësit ligjorë.....   | 23 |
| 2.5. Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë.....   | 25 |
| 2.6. Çështje të tjera .....   | 25 |
| 3. REKOMANDIME.....   | 30 |
| ANEKS 1 - Të dhënat statistikore.....   | 32 |
| Statistikat për periudhën 4 nëntor 2013 – 31 Dhjetor 2013 .....                             | 32 |
| Statistikat për periudhën Janar – Dhjetor 2014.....   | 32 |
| Ngarkesa individuale e gjyqtarëve .....   | 35 |
| Për periudhën 4 nëntor 2013 – 31 Dhjetor 2013 .....   | 35 |
| Për periudhën Janar – Dhjetor 2014 .....  | 36 |
| Të dhëna statistikore krahasimore.....  | 36 |
| Statistika mbi çështjet me objekt marrëdhëniet e punës – statusi i nëpunësit civil .....    | 37 |
| Të dhënat statistikore të Kolegjit Administrativ në Gjykatën e Lartë janar-nëntor 2014..... | 38 |
| ANEKS 2 – Trajnimet .....   | 39 |
| ANEKS 3 – Kontaktet e gjykatave administrative.....   | 41 |

➤ **AKRONIME**

GjAA – Gjykata Administrative e Apelit

LGjA - Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar

MD – Ministria e Drejtësisë

KLD – Këshilli i Lartë i Drejtësisë

SHM – Shkolla e Magjistraturës

➤ **HYRJE**

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. 149, datë 05.12.2014 “Për kryerjen e një studimi vlerësues mbi ngarkesës e punës në Gjykatën Administrative të Apelit”, vendosi kryerjen e një studimi për volumin e çështjeve gjyqësore të regjistruara dhe të gjykuara, në këtë gjykatë. Ky studim synon të vlerësojë situatën aktuale dhe të identifikojë rekomandime konkrete për rritjen e efektivitetit të kësaj gjykate për shkak të volumit të madh të çështjeve gjyqësoretë regjistruara dhe të kërkesave për delegim gjyqtarësh për gjykimin e 3700 çështjeve.

Me vendimin qarkullues nr. 152, datë 18.12.2014 të KLD-së “Për ngritjen e grupit të punës për kryerjen e studimit vlerësues mbi ngarkesës e punës në Gjykatën Administrative të Apelit”, u ngrit grupi i punës i përbërë nga 4 anëtarë: 2 anëtarë përfaqësues të administratës së Këshillit dhe 2 anëtarë përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë:

- i. Znj. Marsida Xhaferllari – Kryeinspektore e Këshillit të Lartë të Drejtësisë
- ii. Vildan Kaloshi – Drejtor Juridik në Këshillin e Lartë të Drejtësisë
- iii. Enerieta Tarelli – Inspektore e Gjyqësorit në Ministrinë e Drejtësisë
- iv. Elona Haska – Inspektore e Gjyqësorit në Ministrinë e Drejtësisë

Për hartimin e këtij studimi, është përdorur analiza krahasimore e të dhënave statistikore brenda sistemit të gjykatave administrative, si dhe i gjykatave administrative në raport me gjykatat e tjera. Këto të dhëna statistikore janë elaboruar duke përdorur kuadrin ligjor në fuqi, si dhe kontekstin historik të prezantimit të gjykatave administrative. Për këtë qëllim, janë përdorur edhe një set dokumentesh si studimi i MD-së të vitit 2012 “Mbi reformën në sistemin gjyqësor - Për rishpërndarjen e numrit të gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit dhe përcaktimi i numrit të gjyqtarëve të gjykatave administrative të shkallës së parë dhe të gjykatës administrative të apelit” dhe raportet e progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë.

Studimi analizon kushtet organizative dhe administrative të funksionimit të Gjykatës Administrative të Apelit, identifikon problematikat përgjatëperiudhës 1-vjeçare të funksionimit të gjykatave administrative, si dhe jep disa rekomandime për adresimin e këtyre problematikave. Ndër rekomandimet e tij, më kryesorët lidhen me rishikimin e numrit të gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit në drejtim të rritjes së këtij numri dhe emërimin e shpejtë të ndihmësve ligjorë.

Studimi u shqyrtua dhe u miratua në mbledhjen plenare të KLD-së të datës 03 mars 2015. Nga shqyrtimi u ndryshua rekomandimi 1, ku tashmë propozohet rritja e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit me 6 gjyqtarë, si dhe u shtua rekomandimi 9 për emërimin sa më të shpejtë të kryetarëve të 5 gjykatave administrative të shkallës së parë, të cilat tashmë drejtohen nga një gjyqtar i deleguar.

## 1. KRIJIMI I GJYKATAVE ADMINISTRATIVE

Gjykatat administrative janë prezantuar për herë të parë me ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar. Synimi i kësaj nisme ligjore ishte reformimi i procedurave gjyqësore të shqyrtimit të mosmarrëveshjeve administrative në drejtim të shpejtësisë dhe cilësisë përmes ngritjes së një sistemi gjyqësor autonom të specializuar me gjyqtarë administrativë. Në zbatim të LGjA, Presidenti i Republikës, MD dhe KLD kanë nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore me qëllim rregullimin e funksionimit të gjykatave administrative.

### 1.1. Kuadri ligjor

Në mbështetje të Dekretit nr. 8349, datë 14.10.2013, të Presidentit të Republikës “Për fillimin e funksionimit të gjykata administrative”, më datë 4 nëntor 2013 filloi funksionimi i gjykatave administrative. Funksionimi i këtyre gjykatave erdhi pas plotësimit të dy kushteve kryesore që lidheshin me:

- hyrjen në fuqi më datë 1 Tetor 2013 të ndryshimeve ligjore në ligjin nr. 8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”<sup>1</sup> për krijimin e Kolegjit Administrativ të kësaj gjykate;
- krijimin e infrastrukturës së nevojshme për ushtrimin normal të veprimtarisë së tyre.

LGjA përcakton segjykatat kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative, janë:

- gjykatat administrative të shkallës së parë,
- Gjykata Administrative e Apelit dhe
- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

Mosmarrëveshjet në kompetencë lëndore të tyre janë:

- a) aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik;
- b) mosmarrëveshjet që lindin për shkak të ndërhyrjes së paligjshme ose të mosveprimit të organit publik;
- c) mosmarrëveshjet e kompetencave ndërmjet organeve të ndryshme administrative në rastet e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative;
- ç) mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, kur punëdhënësi është organ i administratës publike;

<sup>1</sup>Ligji nr. 151/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”

- d) kërkesat e paraqitura nga organet administrative për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, për të cilat ligji parashikon heqjen e lirisë deri në 30 ditë, si një lloj të dënimit administrativ për kundërvajtësin; dhe
- dh) kërkesat e paraqitura nga kundërvajtësit për zëvendësimin e dënimit administrativ me heqje lirie deri në 30 ditë me dënimin me gjobë.

Në mbështetje të nenit 4 të LGjA, Presidenti i Republikës nxori dekretin nr. 7818, datë 16.11.2012, të Presidentit të Republikës “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë, të apelit dhe të gjykatave administrative, si dhe për caktimin e kompetencave tokësore, dhe selisë qendrore të gjykatave administrative” (këtu e në vijim dekreti nr. 7818/2012). Në këtë dekret u përcaktua se gjykatat administrative organizohen në 6 gjykata të shkallës së parë dhe 1 gjykatë apeli. 6 gjykatat administrative të shkallës së parë kanë kompetencë tokësore dhe seli qendrore të ushtrimit të veprimtarisë së tyre, si më poshtë:

- a) Gjykata administrative e shkallës së parë Tiranë, ka kompetencë tokësore në rrethet: Bulqizë, Dibër, Krujë, Laç, Mat dhe Tiranë, me seli qendrore në Tiranë;
- b) Gjykata administrative e shkallës së parë Durrës, ka kompetencë tokësore në rrethet: Elbasan, Gramsh, Librazhd, Peqin, Durrës dhe Kavajë, me seli qendrore në Durrës;
- c) Gjykata administrative e shkallës së parë Shkodër, ka kompetencë tokësore në rrethet Lezhë, Mirditë, Kukës, Has, Pukë, Malësi e Madhe, Shkodër dhe Tropojë, me seli qendrore në Shkodër;
- ç) Gjykata administrative e shkallës së parë Vlorë, ka kompetencë tokësore në rrethet Berat, Skrapar, Kuçovë, Fier, Mallakastër, Lushnjë dhe Vlorë, me seli qendrore në Vlorë;
- d) Gjykata administrative e shkallës së parë Korçë, ka kompetencë tokësore në rrethet Devoll, Kolonjë, Bashkinë Leskovik, Korçë dhe Pogradec, me seli qendrore në Korçë;
- dh) Gjykata administrative e shkallës së parë Gjirokastër, ka kompetencë tokësore në rrethet Gjirokastër, Tepelenë, Përmet, Delvinë dhe Sarandë, me seli qendrore në Gjirokastër;
- e) Gjykata Administrative e Apelit, me seli në Tiranë, ka kompetencë tokësore në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Një prej risive të procedurave gjyqësore administrative është çështja e afateve në gjykimin e çështjeve. Në ndryshim nga neni 327 i K.Pr.Civile, i shfuqizuar, që përcaktonte se shqyrtimi i mosmarrëveshjes duhet të përfundojë brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit në gjykatë, LGjA nuk parashikon afate për gjykimin e mosmarrëveshjeve në gjykatat e shkallës së parë. Tashmë, është vendosur parimi i zhvillimit të gjykimit brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme, që nënkupton përdorimin e afateve në raport me natyrën e veprimit që kërkohet të kryhet për të mos dëmtuar cilësinë e drejtësisë dhe sidomos të drejtën e palëve për t’u mbrojtur efektivisht. Nga ana tjetër, LGjA ka përcaktuar afatin 30 ditor për shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Apelit

Administrativ (neni 48) dhe afatin 90 ditor për shqyrtimin e çështjes në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë (neni 60).

Çështja e afateve merr rëndësi pasi është një prej treguesve matës të veprimtarisë gjyqësore, si në drejtimin e vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve, ashtu edhe në drejtim të identifikimit të përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarit në rastet e zvarritjes së qëllimshme dhe me pasoja të çështjeve gjyqësore. Aktualisht, në inspektimin e veprimtarisë gjyqësore për qëllime të vlerësimit profesional dhe për qëllime të procedimit disiplinor, Inspektorati i KLD-së i referohet kritereve matëse të sistemit të vlerësimit<sup>2</sup> profesional dhe etik të gjyqtarëve. Ky Sistem përcakton si standard matës kohor për çështjet administrative në shkallë të parë afatin 1 muhor dhe për çështjet administrative në gjykatën e apelit afatin 6 muhor.

## 1.2. Kuadri organizativ

Në nenin 8 të ligjit nr. 9877/2008 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se: *numri i gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë dhe për çdo gjykatë të apelit caktohet me dekret nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë. Ministri i Drejtësisë bën propozimet pasi të ketë marrë më parë mendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.* Në të njëjtën linjë, neni 4 i LGjA përcakton se: *kompetencat tokësore, selia qendrore, si dhe numri i gjyqtarëve të gjykatave administrative të shkallës së parë dhe të Gjykatës Administrative të Apelit caktohen me dekret të Presidentit të Republikës, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë. Ministri i Drejtësisë bën propozimet, pasi të ketë marrë më parë mendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.*

### 1.2.1. Numri i gjyqtarëve

Në mbështetje të bazës ligjore të sipërcituar, MD realizoi një studim të situatës mbi ngarkesën dhe tipologjinë e çështjeve të regjistruara për gjykim pranë gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit për të përcaktuar numrin e gjyqtarëve. Ky studim “*Mbi reformën në sistemin gjyqësor - Për rishpërndarjen e numrit të gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit dhe përcaktimi i numrit të gjyqtarëve të gjykatave administrative të shkallës së parë dhe të gjykatës administrative të apelit*” përfundoi në nëntor 2012. Duhet theksuar se studimi u fokusua në analizën e treguesve të të gjithë sistemit të gjykatave në shkallë të parë dhe të apelit për rishpërndarjen e numrit të gjyqtarëve, ku numri i gjyqtarëve administrativë ishte një prej aspekteve.

<sup>2</sup> Shih Vendimin e KLD-së nr. 261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”, Aneksi 1 “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore” pika 5 shkronjat c) dhe h), <http://kld.al/korniza-ligjore/sistemi-i-vleresimit>

Në përcaktimin e numrit të gjyqtarëve u analizua tendenca e numrit të çështjeve të gjykuara në 22 gjykata të shkallës së parë në 6 gjykata të apelit me natyrë civile dhe administrative për vitet 2008 - 2009 – 2010 – 2011. Konkretisht, u analizuan të dhënat statistikore të gjykatave të shkallës së parë mbi numrin e çështjeve me objekt paditë për marrëdhëniet e punës dhe çështjet administrative. Ndërsa në rastin e gjykatave të apelit, për shkak se të dhënat mbledheshin në numër të përgjithshëm, pa të dhëna konkrete për çështjet, u punua mbi të dhënat e çështjeve për marrëdhënie pune dhe çështje administrative nga gjykatat e shkallës së parë, të cilat janë ankimuar pranë këtyre gjykatave.

Nga kjo analizë u konstatua se:

- në vitin 2008, mesatarja e çështjeve të gjykuara për 1 gjyqtar ka qenë 255 çështje në vit;
- në vitin 2009, mesatarja e çështjeve të gjykuara për 1 gjyqtar ka qenë 264 çështjenë vit;
- në vitin 2010, mesatarja e çështjeve të gjykuara për 1 gjyqtar ka qenë 246 çështje;
- për vitin 2011, mesatarja e çështjeve të gjykuara për 1 gjyqtar ka qenë 297 çështje.

Nga të dhënat e mësipërme u nxor rezultati se një gjyqtar ka patur për gjykim 246 deri në 297 çështje në vit. Sipas standardit të dhënë nga Misioni Euralius II, ngarkesa mesatare e çështjeve për 1 gjyqtar duhet të jetë 215 çështje për gjyqtar, ndërkohë që Misioni Euralius III, në studimin e muajit mars 2012, dha një standard tjetër të ngarkesës mesatare prej 240 çështje për 1 gjyqtar.

Studimi iu nënshtrua procesit të konsultimit me të gjithë kryetarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, të cilët përgjithësisht pranuan nevojën e rishpërndarjes së numrit të gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit dhe të përcaktimit të numrit të gjyqtarëve të gjykatave administrative. Sipas tyre, rishpërndarja duhet të mbante në konsideratë ngarkesën mesatare të çështjeve për gjyqtarë që kanë gjykatat dhe tipologjinë e çështjeve të regjistruara për gjykim pranë çdo gjykate. Gjithashtu, nga procesi i konsultimit pati edhe sugjerime konkrete si:

*Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Durrës u shpreh mbi nevojën e rritjes së numrit të gjyqtarëve të gjykatës administrative të rrethit gjyqësor Durrës me jo më pak se 5 gjyqtarë dhe jo më shumë se 7 gjyqtarë; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë sugjeroi uljen e numrit të gjyqtarëve të kësaj gjykate në 14 ose 15 gjyqtarë; Gjykata e Apelit Gjirokastër sugjeroi që në gjykatat e vogla, numri të ishte 4 gjyqtarë; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër sugjeroi uljen e numrit të gjyqtarëve deri në 6 gjyqtarë; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin sugjeroi rritjen e numrit të gjyqtarëve të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Kurbin, Dibër, Kukës dhe Pogradec.*

Në mbështetje të nenit 8 të ligjit nr. 9878/2008 dhe të nenit 4 të LGJA, si dhe në adresim të rekomandimeve të dala nga studimi, MD përcolli për mendim pranë KLD-së draft dekretin “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë dhe të apelit, si dhe për caktimin e kompetencave tokësore, dhe selisë qendrore të gjykatave administrative”. Draft



dekreti i propozuar nga MD u diskutua në KLD nëmbledhjen plenare të zhvilluar më datë 9.11.2012. Përkundrejt vlerësimit pozitiv që i bëri studimit mbi të cilin është ideuar dekreti, KLD prezantoi edhe disa mendime mbi numrin e gjyqtarëve në gjykata ashtu si dhe mbi përcaktimin e kompetencave tokësore<sup>3</sup>.

Konkretisht, duke vlerësuar ngarkesën e madhe prej çështjeve që mbart Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Durrës, anëtarët e KLD-së kanë vlerësuar se propozimi i draft dekretit, vetëm me 19 gjyqtarë, duke përfshirë në këtë numër edhe 4 gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, nga 24 gjyqtarë që ushtronin detyrën, do të krijonte një situatë të papërbalueshme të ngarkesës së punës. Ky mendim i prezantuar nga KLD është reflektuar në Dekretin nr. 7818, datë 16.11.2012, që tashmë është në fuqi, dhe nga 19 gjyqtarë që ishte propozimi, numri i gjyqtarëve është 21, duke përfshirë këtu edhe 4 gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Të njëjtin shqetësim KLD prezantoi edhe për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan ku sugjerohej të mos ndryshonte numrii gjyqtarëve, pasi çdo ulje e këtij numri do të cenonte drejtpërsëdrejti cilësinë në ushtrimin e detyrës e përrjedhojë në dhënien e drejtësisë. Megjithatë, numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan u ul nga 17 gjyqtarë në 14 gjyqtarë.

Gjithashtu, KLD shprehu mendimin etij mbi kompetencën territoriale të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrës, duke kërkuar që të mos përfshihej Bashkia e Leskovikut, për shkak, të largësisë nga Qyteti i Gjirokastrës. Meqë kjo bashki në ndarjen territoriale, ishte pjesë e Qarkut të Korçës, u sugjerua të përfshihej në kompetencën territoriale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Ky sugjerim u reflektua në Dekretin e miratuar.

Nga analiza e qëndrimit të KLD-së përgjatë procedurës së konsultimit të dekretit të numrit të gjyqtarëve konstatohet se KLD ka dhënë mendim përgjithësisht mbi numrin e gjyqtarëve dhe mbi kompetencat tokësore. KLD nuk është shprehur specifikisht për numrin e gjyqtarëve administrativë.

Në përfundim u konkludua që numri prej 43 gjyqtarësh (36 gjyqtarë në shkallë të parë dhe 7 gjyqtarë në gjykatën e apelit) ishte i mjaftueshëm për të përballuar një standard prej 246 çështjesh gjyqësore (administrative dhe konflikte pune me punëdhënës organ publik). Në përmbyllje të kësaj procedure, MD e përcolli aktin përmiratim pranë Presidentit të Republikës, që u finalizua me dekretin nr. 7818, datë 16.11.2012 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë, të apelit dhe të gjykatave administrative, si dhe për caktimin e kompetencave tokësore, dhe selisë qendrore të gjykatave administrative”.

<sup>3</sup>Shih shkresën e KLD-së nr. 1935 prot., datë 12.11.2012

Sipas dekretit nr. 7818/2012 të Presidentit të Republikës, numri i përgjithshëm i gjyqtarëve në të dy shkallët e gjykimit është 383 gjyqtarë, të rishpërndarë në:

- 287 gjyqtarë në shkallët e para dhe
- 96 gjyqtarë në gjykatat e apelit.

Gjithashtu, dekreti shpërndan numrin e gjyqtarëve sipas profilit të gjykatave të specializuara në bazë të lëndës:

- 313 gjyqtarë në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm;
- 27 gjyqtarë në gjykatat për krime të rënda;
- 43 gjyqtarë në gjykatat administrative.

Duke i krahasuar shkallët e gjykimit me lëndën, numri i gjyqtarëve është i shpërndarë si më poshtë:

- 235 gjyqtarë në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të shkallës së parë;
- 16 gjyqtarë në gjykatën e shkallës së parë të Krimeve të Rënda
- 36 gjyqtarë në gjykatat administrative të shkallës së parë;
- 78 gjyqtarë në gjykatat e apelit të juridiksionit të zakonshëm;
- 11 gjyqtarë në gjykatën e apelit të Krimeve të Rënda;
- 7 gjyqtarë në gjykatën administrative të apelit.

Gjithashtu, Kryetari i Gjykatës së Lartë, mbështetur në ligjin nr. 8588/2000, i ndryshuar dhe nëLGjA, nxori Urdhrin nr. 241, datë 01.11.2013 “Për ndarjen e gjyqtarëve në kolegje”. Sipas këtij urdhri, Kolegji Administrativ përbëhet nga 6 gjyqtarë dhe trupat gjyqësorë për shqyrtimin e çështjeve gjyqësore administrative përbëhen nga 3 gjyqtarë. Në këtë mënyrë, nuk ka diferenca domethënëse në numrin e gjyqtarëve të Kolegjit Civil, Penal dhe Administrativ.

Nga sa më lart, rezulton se raporti i numrit të gjyqtarëve administrativë të shkallës së parë ndaj gjyqtarëve të shkallës së parë të juridiksionit të zakonshëm është 1:15, ndërsa në gjykatat e apelit ky raport është 1:20.

Duke iu referuar të dhënave statistikore<sup>4</sup> të 6-mujorit të parë të vitit 2014, të raportuara nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm mbi numrin e çështjeve civile të regjistruara dhe të shqyrtuara prej tyre krahasimisht me numrin e çështjeve gjyqësore të regjistruara dhe të shqyrtuara nga gjykatat administrative, rezultojnë të dhënat e mëposhtme, të ndara sipas dy shkallëve të gjykimit:

---

<sup>4</sup> Statistikat e përfshira në këtë studim kanë një rezervë në drejtim të saktësisë, pasi procesi i përpunimit teknik të tyre është ende në proces

- pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të zakonshëm janë regjistruar 31266 çështje dhe kanë përfunduar me vendim 19416 çështje;
- pranë gjykatave administrative të shkallës së parë janë regjistruar 18409 çështje dhe kanë përfunduar me vendim 10640 çështje.
- pranë gjykatave të apelit të juridiksionit të zakonshëm janë regjistruar 20261 çështje dhe janë shqyrtuar 7890 çështje;
- pranë gjykatës administrative të apelit janë regjistruar 6585 çështje dhe janë shqyrtuar 2603 çështje.

Këto të dhëna tregojnë se në shkallë të parë raporti i numrit të çështjeve të regjistruara në gjykatat administrative ndaj numrit të çështjeve të regjistruara në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është 1:1.7 (59%), ndërsa raporti i numrit të vendimeve të dhëna është 1:1.8 (55%). Në shkallë të dytë, raporti i çështjeve të regjistruara është 1:3.1 (33 %), ndërsa raporti i numrit të vendimeve të dhëna është 1:3 (33%). Në këtë analizë evidentohet se nuk ka një raport të drejtë midis treguesve për numrin e gjyqtarëve dhe volumit të ngarkesës midis gjykatave administrative dhe gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Ky konkluzion ka rezervat e veta, për shkak të dinamikës institucionale. Në këtë kontekst, duhet evidentuar se volumi fillestar i gjykatave administrative nuk pasqyron një gjendje statike dhe pritet të ndryshojë për shkak të disa faktorëve si: (i) kalimi i periudhës tranzitore, si pasojë e të cilës në gjykatat administrative kaluan *en block* një numër i lartë çështjesh ekzistuese, gjykimi i të cilave filloi nga e para; (ii) fillimi i funksionimit të tyre menjëherë pas zgjedhjeve të përgjithshme në Republikën e Shqipërisë dhe pas hyrjes në fuqi të reformës së nëpunësit civil; (iii) konsolidimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve dhe unifikimi i praktikës gjyqësore; (iv) përmirësimi i kushteve të punës.

Nga ana tjetër, efekti financiar i rishpërndarjes së numrit të gjyqtarëve në shkallë të parë dhe të dytë është llogaritur në bazë të pagës mesatare për funksion të një gjyqtari, e ndarë sipas dy viteve: për vitin 2013 dhe për vitin 2014. Ky veçim është bërë për shkak se në vitin 2013, me nismë të MD u miratua ligji nr. 114/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, i cili përmirësoi statusin e gjyqtarëve të shkallës së parë dhe apelit, nëpërmjet rritjes së pagave të tyre<sup>5</sup>. Ligji nr. 144/2013 parashikon që efektet e pagës së re fillojnë në datën 1 Janar 2014. Në këtë situatë të dhënat janë si më poshtë:

<sup>5</sup>Përveç pagës për funksion, gjyqtarët përfitojnë shtesa mbi pagë për: a) vjetërsi në shërbim; b) gjyqtarët e gjykatave për krimet e rënda përfitojnë 10% shtesë veshitësie mbi pagën për funksion të gjykatës së shkallës së parë apo apelit; c) kryetarët e gjykatave përfitojnë shtesë për drejtim në masën 10% të pagës për funksion të gjyqtarëve të gjykatës respektive

2015

| Gjyqtar                    | Paga mujore mesatare për funksion në vitin 2013, në lekë | Paga mujore për funksion në vitin 2014, në lekë |
|----------------------------|--|---|
| Gjykata e Shkallës së Parë | 87,040   | 104,856   |
| Gjykata e Apelit           | 121,856  | 131,070   |

Efektet financiare të numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve llogariten në:

| Emërtimi   | Numri sipas dekretit të Presidentit | Përlllogaritja e pagave për vitin 2013, në lekë | Përlllogaritja e pagave për vitin 2014, në lekë |
|--|-------------------------------------|---|---|
| Nr. i gjyqtarëve në gjykatat e rretheve gjyqësor | 287                                 | 299,765,760                                     | 361,124,064                                     |
| Nr. i gjyqtarëve në gjykatat e apelit            | 96                                  | 140,378,112                                     | 150,992,640                                     |
| <b>Gjithsej</b>                                  | <b>383</b>                          | <b>440,143,872</b>                              | <b>512,116,704</b>                              |

Nga analiza e këtyre të dhënave konstatohet se ka një rritje të efektit financiar në buxhetin e shtetit për shkak të dy faktorëve: (i) rritja e pagës së gjyqtarit me ligj; dhe (ii) rritja e numrit të gjyqtarëve të apelit. Kuadri ligjor nuk bën diferenca në pagën e gjyqtarit të juridiksionit të zakonshëm nga ajo e gjyqtarit administrativ, pasi LGjA nuk përcakton kritere në llogaritjen e pagës së gjyqtarit të gjykatave administrative. Në nenin 5 të LGjA parashikohet se statusi i gjyqtarëve të gjykatave administrative rregullohet sipas dispozitave të ligjit nr. 9877/2008, me përjashtim të rastit kur në këtë ligj parashikohet ndryshe. Nga kjo dispozitë rrjedh përfundimi që paga mujore e gjyqtarit të gjykatave administrative është e njëjtë me pagën e gjyqtarit të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Për pasojë, kostoja financiare për pagën mujore të një gjyqtari administrativ të shkallës së parë është 104,856 lekë, ndërsa për pagën mujore të një gjyqtari administrativ të Gjykatës së Apelit është 131,070 lekë.

### 1.2.2. Numri i administratës gjyqësore

Kriteret e përcaktuara në studimin e rishpërndarjes së numrit të gjyqtarëve të vitit 2012 u mbajtën në konsideratë edhe nëpërgatitjen e strukturave organike të gjykatave administrative. Më konkretisht:

- i) në gjykatat e shkallës së parë, numri i sekretareve gjyqësore është në raport 1:1 me numrin e gjyqtarëve, ndërsa në gjykatat e apeleve raporti është 3 gjyqtarë me 2 sekretare gjyqësore;

- ii) standardizimin e numrit të punonjësve të administratës gjyqësore në gjykatat ku numri i gjyqtarëve është i njëjtë;
- iii) në Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë, funksionet e specialistit të teknologjisë së informacionit/marrëdhënies me publikun e median, dhe të arkivistit do të realizohen respektivisht nga punonjësit e të njëjtit pozicion të Gjykatës së Apelit Shkodër, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë<sup>6</sup>.

Në bazë të urdhrin nr. 153, datë 04.03.2014, të Ministrin të Drejtësisë “Për miratimin e strukturave dhe organikave të gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit”, numri i stafit në gjykatat administrative është 135 punonjës:

- 43 gjyqtarë; dhe
- 92 administratë gjyqësore: 7 kancelarë; 2 kryesekretarë; 44 sekretarë gjyqësorë; 8 nëpunës gjyqësorë; 7 Kryetarë Buxheti; 3 Specialist IT; 3 arkivist dhe 18 punonjës mbështetës.

Organika dhe struktura e GjAA paraqitet si më poshtë:

| Nr.          | Funksioni  | Numri organik |
|--------------|--|---------------|
| 1.           | Kryetar  | 1             |
| 2.           | Gjyqtarë   | 6             |
| 3.           | Kancelar   | 1             |
| 4.           | Kryesekretar   | 1             |
| 5.           | Sekretar gjyqësorë   | 7             |
| 6.           | Nëpunës gjyqësor   | 1             |
| 7.           | Kryetar i Degës së Buxhetit                                      | 1             |
| 8.           | Specialist IT dhe punonjës i marrëdhënies me publikun dhe mediat | 1             |
| 9.           | Arkivist   | 1             |
| 10.          | Sanitar  | 1             |
| 11.          | Shofer dhe mirëmbajtës   | 1             |
| <b>Total</b> |  | <b>22</b>     |

Raporti i punonjësve të administratës gjyqësore me numrin e gjyqtarëve në GjAA është: 12 punonjës<sup>7</sup> me 7 gjyqtarë, pra ‘1.9 punonjës për 1 gjyqtar’ dhe ‘1 sekretare për 1 gjyqtar’. Administratës gjyqësore në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë i është dhënë përparësi, pasi në Gjykatat e Apelit të juridiksionit të zakonshëm raporti është “2 sekretare për 3 gjyqtarë”. Në draft raportin e Këshillin e Evropës për Shqipërinë që lidhet me Sistemin Gjyqësor<sup>8</sup> (CEPEJ) për

<sup>6</sup>Lidhur me këtë çështje Ministria e Drejtësisë është në proces rishikimi të strukturave të gjykatave në bazë të planifikimeve buxhetore për administratën gjyqësore të parashikuara për vitin 2015.

<sup>7</sup> Ky numër nuk përfshin punonjësit e shërbimeve mbështetëse: sanitar dhe shofer/mirëmbajtës

<sup>8</sup> Prezantuar në nëntor 2014, fq. 9 e dokumentit

vitin 2012konstatohet se numri e administratës gjyqësore në sistemin gjyqësor shqiptar është më i vogël se mesatarja evropiane ‘*3 punonjës për 1 gjyqtar*’.

## 2. SITUATA AKTUALE

Në situatën aktuale të funksionimit të gjykatave administrative prej 1 viti e 3 muaj identifikohen disa çështje që ndikojnë në efikasitetin e tyre. Të tilla çështje janë: (i) ngarkesa e gjykatave administrative (ii) vakancat në numrin e gjyqtarëve; (iii) administrata gjyqësore dhe ndihmësit ligjorë (iv) vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë; dhe (v) çështje të tjera që lidhen me infrastrukturën, dixhitalizimin dhe trajnimet.

### 2.1. Vlerësimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar

Krijimi i gjykatave administrative gjeti mbështetje në disa dokumente politike qeveritare të tillë si: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007 – 2013<sup>9</sup>; Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike, 2009-2013<sup>10</sup>; Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2011 – 2013<sup>11</sup>. Gjykatat administrative janë mbështetur si reformë në vijim edhe nga Plani Kombëtar për Integrimin Evropian, 2014 – 2020<sup>12</sup>, ku citohet se:

“Plotësimi i vendeve vakante të gjyqtarëve në gjykatat administrative të shkallës së parë në Gjirokastrë, Vlorë, Korçë dhe Shkodër dhe përfundimi i strukturës organizative të gjykatave administrative me numrin e nevojshëm të punonjësve të administratës gjyqësore, përfshi edhe asistentët ligjorë, përbën një tjetër masë.... Bërja e Gjykatave Administrative plotësisht funksionale është një nga prioritetet afat-shkurtër, që do të adresohet nga një numër masash të parashikuara për këtë qëllim, kryesisht investim në mjediset e punës së gjykatave administrative të sapo-themelura, së bashku me masat për rritjen e luftës kundër korrupsionit në gjyqësor... Procedura për emërimin e gjyqtarëve administrative duhet finalizuar...”

Në Raport Progresin e Komisionit Evropian për Shqipërinë të lëshuar në 8 tetor 2014 është njohur si progres fillimi i funksionit të gjykatave administrative<sup>13</sup>:

“Zbatimi i Ligjit për Gjykatat Administrative ka shënuar përparim, kur gjykatat filluan funksionimin në nëntor 2013. Ato punojnë rregullisht, duke dhënë vendime brenda afateve të arsyeshme, pavarësisht se kanë ngarkesë pune të madhe. Vendet vakante për gjyqtarët dhe ndihmësit e tyre ende nuk janë plotësuar plotësisht, dhe sistemi i administrimit të çështjeve duhet të bëhet funksional. Gjykatat administrative kanë filluar të funksionojnë, por duhet të

<sup>9</sup> Shih në [http://www.dap.gov.al/images/Arkiva/SKZHI\\_2007-2013.pdf](http://www.dap.gov.al/images/Arkiva/SKZHI_2007-2013.pdf)

<sup>10</sup> VKM nr. 1017, datë 18.09.2009

<sup>11</sup> VKM nr. 519, datë 20.07.2011

<sup>12</sup> VKM nr. 438, datë 2.7.2014

<sup>13</sup> Shih faqet nr. 12, 13, 22, 48, 49 në adresën <http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/progres-raporte/progres-raporti-2014&page=1>, aksesuar më 16/01/2015

bëhen plotësisht funksionale. Janë bërë disa përpertime në ngritjen e gjykatave administrative, që u bënë funksionale në nëntor.

Zbatimi i Ligjit për Gjykatat Administrative (2012) filloi në nëntor. Janë ngritur gjashtë gjykata administrative, Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Megjithatë, me përjashtim të Tiranës, këto gjykata funksionojnë me vetëm 50% të numrit të punonjësve të caktuar, dhe gjyqtarët atashohen nga gjykatat e tjera për të plotësuar panelet. Duhet të vihen në dispozicion ose të rinovohen një numër godinash, dhe ndihmësit ligjorë duhet të emërohen sipas procedurës që përcaktojnë ndryshimet që i janë bërë ligjit në korrik. Nëntë vende vakante për gjyqtarë ende nuk janë plotësuar. Në këtë drejtim, duhet të miratohet një proces rekrutimi stimulues, duke parë mospjesëmarrjen në provimin e pranimit. Pjesa më e madhe e ngarkesës së punës përbëhet nga çështje të shkarkimit të nëpunësve publikë dhe konfliktet e pronësisë; duhet të vlerësohet pesha e ngritjes së gjykatave administrative në përmirësimin edhe specializimin e mbrojtjes ligjore në të gjitha çështjet ku shteti është palë.”

## 2.2. Ngarkesa e gjykatave administrative

Duke iu referuar të dhënave statistikore konstatohet një volum shumë i lartë çështjesh të regjistruara në gjykatat administrative. Konkretisht, përgjatë vitit 2014 janë regjistruar 55479 çështje, nga të cilat 36558 çështje në shkallë të parë dhe 18921 çështje në Gjykatën e Apelit. Gjatë të njëjtës periudhë, janë dhënë 24211 vendime gjyqësore, nga të cilat 19600 vendime në shkallë të parë dhe 4611 vendime në gjykatën e apelit. Këto të dhëna tregojnë se numri mesatar i çështjeve të regjistruara për 1 gjyqtar në shkallë të parë është 1261 çështje<sup>14</sup> ose 1016 çështje<sup>15</sup>, ndërsa në gjykatën e apelit është 2703 çështje. Po ashtu, numri i vendimeve të dhëna nga 1 gjyqtar në shkallën e parë është 676 vendime, ndërsa në gjykatën e apelit është 659. Në raport me standardin e parashikuar në përcaktimin e numrit të gjyqtarëve prej 246 çështje, konstatohet se ka një rritje shumë të ndjeshme të ngarkesës në raportin 1:5 për gjyqtarin e shkallës së parë dhe 1:11 për gjyqtarin e gjykatës së apelit.

Nga të dhënat statistikore konstatohet se në shkallë të parë, gjykata me ngarkesën më të lartë të çështjeve të regjistruara është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me 18417 çështje, më tej vijojnë: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës me 4173 çështje; Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me 3720 çështje; Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë me 3494 çështje; Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë

<sup>14</sup> Kjo shifër është llogaritur me numrin 29 gjyqtarë që aktualisht ushtrojnë detyrën në gjykatat administrative të shkallës së parë

<sup>15</sup> Kjo shifër është llogaritur nëse struktura e gjykatave administrative të shkallës së parë do të ishte e plotë me 36 gjyqtarë



me 3436 çështje dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me 3720 çështje. Gjykata me numrin më të lartë të vendimeve të dhëna është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me 8587 vendime, më tej vijojnë: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë me 3077 vendime; Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës me 2658 vendime; Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë me 2240 vendime; Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me 2112 vendime dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me 926 vendime.

Ndërkohë që gjykata me numrin më të lartë të vendimeve të dhëna nga një gjyqtar në raport me numrin faktik të tyre është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë me 1539 vendime për gjyqtar, më tej vijojnë: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë me 1120 vendime për gjyqtar; Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me 704 vendime për gjyqtar; Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës me 665 vendime për gjyqtar; Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me 463 vendime për gjyqtar dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me 533 vendime për gjyqtar.

Këto të dhëna paraqiten në format tabelar si më poshtë:

*Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë*

| Gjykata      | Çështjet gjyqësore në vitin 2014 |               |
|--------------|----------------------------------|---------------|
|              | Të regjistruara                  | Të shqyrtuara |
| Durrës       | 4173                             | 2658          |
| Gjirokastrë  | 3494                             | 3077          |
| Korçë        | 3436                             | 2240          |
| Shkodër      | 3720                             | 926           |
| Vlorë        | 3318                             | 2112          |
| Tiranë       | 18417                            | 8587          |
| <b>Total</b> | <b>36558</b>                     | <b>19600</b>  |

*Gjykata Administrative e Apelit*

| Gjykata | Çështjet gjyqësore në vitin 2014 |               |
|---------|----------------------------------|---------------|
|         | Të regjistruara                  | Të shqyrtuara |
| Tiranë  | 18921                            | 4611          |

Në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë rezulton se përgjatë periudhës janar – nëntor 2014 janë regjistruar gjithsej 6821 çështje nga të cilat janë shqyrtuar 1599 çështje dhe janë në proces 5222 çështje. Në raport me numrin e trupave gjykues ngarkesa rezulton të jetë rreth 800 çështje të gjykuara për 1 trup gjykues dhe 2611 çështje në proces për 1 trup gjykues.

Nëse krahasojmë të dhënat statistikore të 9-mujorit të parë të vitit 2014 (janar – shtator), të çështjeve civile dhe atyre administrative të regjistruara dhe gjykuara në gjykatat respektive të apelit Tiranë, rezulton se në Gjykatën e Apelit Tiranë janë regjistruar 11446 çështje civile dhe janë gjykuar 3250 çështje, ndërsa në Gjykatën Administrative të Apelit për të njëjtën periudhë janë regjistruar 11548 çështje dhe janë gjykuar 3590 çështje. Nga këto të dhëna rezulton se numri mesatar i çështjeve të regjistruara për 1 gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë është 440 çështje dhe në Gjykatën Administrative të Apelit është 1650 çështje. Po kështu, numri i vendimeve të dhëna nga 1 gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë është 125 vendime ndërsa në Gjykatën Administrative të Apelit është 513 vendime. Në raport me numrin mesatar të çështjeve që duhet të gjykojë 1 gjyqtar, për Gjykatën e Apelit Tiranë raporti është 1:1.2 dhe për Gjykatën Administrative të Apelit raporti është 1:7.

Të dhëna më të detajuara për volumin e çështjeve në gjykatat administrative dhe ngarkesën e gjyqtarëve jepen në Aneksin 1 të këtij Studimi.

Volumi i lartë i çështjeve gjyqësore dhe vendet vakante në 4 prej gjykatave administrative të shkallës së parë kanë ndikuar edhe nëparaqitjen e kërkesave për delegimin e gjyqtarëve në këto gjykata, me arsyetimin se gjykatat administrative nuk kanë patur mundësi të shqyrtojnë disa çështje gjyqësore në kohën e duhur. Kërkesa më ekstreme i përket Gjykatës së Apelit Administrativ, e cila së fundmi kërkoi në KLD delegimin e gjyqtarëve për gjykimin e 3700 çështjeve gjyqësore.

KLD, duke filluar nga mesi i muajit Prill 2014 iu ka kërkuar kryetarëve të gjykatave administrative informim periodik mujor mbi çështjet e mëposhtme:

- 1) Respektimin e afatit të dorëzimit të vendimeve të arsyetuara në sekretarinë gjyqësore;
- 2) Probleme të respektimit të disiplinës në punë;
- 3) Respektimin e normave të etikës gjyqësore me palët pjesëmarrëse, me kolegët dhe titullarin e gjykatës
- 4) Zbatimin e vendimit nr. 232/8, data 07.07.2008 të KLD-së “Për solemnitetin e gjykimit dhe veshjen e posaçme të gjyqtarit;
- 5) Vonesat e seancave gjyqësore;
- 6) Raportimi mbi instalimin dhe funksionimin e sistemit të regjistrimit audio të implementuar në gjykatat respektive, mbi funksionimin e sistemit ICMIS, si dhe me rastet dhe arsyet e mbajtjes së procesverbaleve me dorëshkrim, për të gjitha rastet që do të evidentohen;
- 7) Çdo situatë tjetër problematike të konstatuar.

Në periudhën Prill –Nëntor 2014, prej kryetarëve të gjykatave administrative është paraqitur informacioni periodik i kërkuar në lidhje me problematikat e konstatuara në gjykatat respektive. Përgjithësisht raportimi i tyre ka qenë i rregullt, me përjashtim të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë që nuk është raportuar që nga muaji Maj 2014<sup>16</sup>. Duhet theksuar se volumi i lartë i çështjeve gjyqësore ka qenë një shqetësim konstant i paraqitur nga të gjithë kryetarët e gjykatave administrative.

Nga analiza e të dhënave të paraqitura nga raportimi periodik i kryetarëve përgjatë periudhës Prill-Nëntor të vitit 2014 është konstatuar se në lidhje me vonesat mbi 30 ditë në arsyetimin e vendimeve gjyqësore problematika më e madhe është në Gjykatën e Administrative të Apelit. Në gjykatat e shkallës së parë nuk janë raportuar vonesa mbi 30 ditë, me përjashtim të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për 5 raste të 2 gjyqtarëve në muajin Nëntor 2014. Lidhur me këto vonesa, kryetari i Gjykatës së Apelit Administrativ ka parashtruar me shkrim se nga trupa e kësaj gjykate është vlerësuar se afati i dorëzimit të dosjeve sipas nenit 42/3 të LGjA, është i shkurtër, pasi volumi i punës është shumë i lartë tek kjo gjykatë. Po ashtu, sipas tij një prej faktorëve që ka ndikuar në vonesat e arsyetimit të vendimeve gjyqësore është mungesa e ndihmësve ligjorë.

| Muaji                        | Nr. Gjyqtarëve |           | Nr. Gjykatave |           | Nr. Vendimeve |           |
|------------------------------|----------------|-----------|---------------|-----------|---------------|-----------|
|                              | Apel           | Shkalla 1 | Apel          | Shkalla 1 | Apel          | Shkalla 1 |
| Maj                          | 6              | -         | 1             | -         | 402           | -         |
| Qershor                      | 6              | -         | 1             | -         | 158           | -         |
| Korrik                       | 6              | -         | 1             | -         | 303           | -         |
| Shtator                      | -              | -         | -             | -         | -             | -         |
| Tetor                        | 3              | -         | 1             | -         | 24            | -         |
| Nëntor                       | 3              | 2         | 1             | 1         | 10            | 5         |
| <b>Gjithsej<sup>17</sup></b> | <b>7</b>       | <b>2</b>  | <b>1</b>      | <b>1</b>  | <b>897</b>    | <b>5</b>  |

Nga analiza e të dhënave konstatohet se tendenca si për numrin e gjyqtarëve dhe të vendimeve gjyqësore përsa i përket Apelit Administrativ ka një ulje të madhe që nga muaji Shtator 2014. Përsa i përket gjykatave administrative të shkallës së parë, ndonëse paraqitet mjaft i vogël si numri i gjyqtarëve dhe i vendimeve, evidentohet shfaqja e kësaj problematike në muajin Nëntor 2014.

Informacioni periodik për arsyetimin me vonesë të vendimeve gjyqësore i muajit Maj dhe Qershor 2014, që i përket Gjykatës Administrative të Apelit, është verifikuar dhe vonesat e konstatuara u janë evidentuar 5 gjyqtarëve për efekt të vlerësimit profesional dhe etik. Për 1

<sup>16</sup>Informacioni është përpunuar nga Inspektorati dhe Administrata e KLD-së.

<sup>17</sup> Në nxjerrjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve dhe të gjykatave, është mbajtur në konsideratë, që i njëjti gjyqtar apo e njëjta gjykatë ka patur vonesa në muaj të ndryshëm

gjqqtar shkeljet nuk u provuan dhe aktet janë arkivuar. Aktualisht është në proces ende verifikimi i raportimeve të muajve të tjerë.

Me urdhrin nr. 671, datë 11.12.2014 të Ministrit të Drejtësisë është urdhëruar inspektimi tematik në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe të Apelit Tiranë. Objekt i këtij inspektimi është verifikimi i zbatimit të dispozitave procedurale administrative në gjykimin e çështjeve në këto gjykata nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë deri në datën e dërgimit të çështjes mbi bazë ankimi në gjykatën më të lartë. Inspektimi filloi më datë 15.12.2014 dhe përfundoi në datën 23.01.2015. Ankesat e paraqitura në MD janë pjesë e procedurave të këtij inspektimi. Aktualisht, MD po punon për hartimin e raportit. Ndërkohë, edhe KLD me vendimin e datës 26.01.2015, ka vendosur në parim inspektimin tematik të gjykatave administrative, duke ngarkuar Inspektoratin për hartimin e një plani pune.

Gjatë periudhës 3 Nëntor 2013 deri më 27 Janar 2015 në Inspektoratin e KLD-së janë paraqitur 67 ankesa për gjyqtarët e gjykatave administrative të Shkallës Parë dhe Apelit. Në 17 raste ankesat janë verifikuar, duke përfutur rezultatet e mëposhtme:

- 6 ankesa kanë rezultuar pa shkelje;
- 5 ankesa janë evidentuar për efekt vlerësimi profesional dhe etik të gjyqtarëve;
- 5 ankesa janë në vijim verifikimi deri në përfundim të gjykimit në gjykatat më të larta;
- 1 ankesë është konkluduar me tërheqjen e vëmendjes së gjyqtarit, pasi shkeljet e konstatuara nuk kanë qenë të përshtatshme për procedim disiplinor.

Në 39 raste, ankesat e paraqitura janë arkivuar:

- 15 ankesa janë arkivuar me arsyetimin se pretendimet zgjidhen mbi bazën e apelit gjyqësor;
- 24 ankesa janë arkivuar me arsyetimin se janë të përsëritura.

Janë në proces verifikimi 9 ankesa, ndërsa 2 ankesa të tjera janë në proces shqyrtimi paraprak.

Analiza e këtyre të dhënave konfirmon faktin e ngarkesës së lartë sasiore të gjyqtarëve administrativë, sidomos në Gjykatën e Apelit, që duket të jetë edhe një prej faktorëve që ndikon në vonesat në arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Kjo çështje kërkon ndërhyrje pasi këto vonesa po dëmtojnë qytetarët, të cilët kanë paraqitur ankesa.

### **2.3. Vakancat në numrin e gjyqtarëve**

Në bazë të dekretit të Presidentit nr. 7818/2012 që përcakton numrin e gjyqtarëve në gjykatat e faktit, numri i gjyqtarëve që duhet të ushtrojnë detyrën në gjykatat administrative duhet të jetë 43 gjyqtarë, ndërkohë që aktualisht ushtrojnë detyrën 36 gjyqtarë. Përsa i përket ndarjes gjinore në

këto Gjykata, numrin më të madh e zënë femrat me 19 gjyqtarë përkundrejt 17 gjyqtarë meshkuj. Moshë mesatare e këtyre gjyqtarëve është 40 vjeç. Nëse i referohemi të dhënave gjinore në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm rezulton se raporti ndërmjet gjyqtareve femra me gjyqtarë meshkuj është 51%.

Nga hyrja në fuqi e LGjA dhe dekretit nr. 7818/2012, janë dekretuar:

- 7 gjyqtarë në Gjykatën Administrative të apelit dhe
- 29 gjyqtarë në gjykatat administrative të shkallës së parë:
  - 16 gjyqtarë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
  - 4 gjyqtarë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës;
  - 2 gjyqtarë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë;
  - 3 gjyqtarë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë;
  - 2 gjyqtarë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe
  - 2 gjyqtarë Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë në Shkodër.

Vakancat në gjykatat administrative janë 7 gjyqtarë, shpërndarja e të cilëve jepet në tabelën e mëposhtme:

| Gjykata administrative | Numri i gjyqtarëve në gjykatat administrative |              |         | Kryetarë |
|------------------------|---|--------------|---------|----------|
|                        | Dekreti 7818/2012                             | Të Dekretuar | Vakanca |          |
| Apeli Tiranë           | 7   | 7            | 0       | Emëruar  |
| Shkalla 1 Durrës       | 4   | 4            | 0       | Deleguar |
| Shkalla 1 Gjirokastrë  | 4   | 2            | 2       | Deleguar |
| Shkalla 1 Korçë        | 4   | 2            | 2       | Deleguar |
| Shkalla 1 Shkodër      | 4   | 2            | 2       | Deleguar |
| Shkalla 1 Tiranë       | 16  | 16           | 0       | Emëruar  |
| Shkalla 1 Vlorë        | 4   | 3            | 1       | Deleguar |

Po ashtu, nga të dhënat e pasqyruara në tabelë konstatohet se deri sot janë emëruar vetëm 2 kryetarë nga 7 gjithsej – kryetari i Gjykatës Administrative të Apelit dhe kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Në 5 gjykatat e tjera të shkallës së parë Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, KLD ka deleguar një gjyqtar të asaj gjykate për ushtrimin e funksioneve të kryetarit, për shkak të vakancave të gjyqtarëve në këto gjykata. Gjithësesi, KLD vlerëson se emërimi i kryetarëve është një proces një ndihmon në efektivitetin e punës në këto gjykata.

LGjA, i jep KLD-së të drejtën për realizimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve që do të emërohen në gjykatat administrative të shkallës parë dhe të apelit administrativ, në

bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, pas kryerjes së testimit kualifikues. Me këtë bazë ligjore, KLD miratoi vendimin nr.299/1, datë 30/11/2012 “Për procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe të Apelit”, duke krijuar dy komisione, i) Komisionine Fondit të Pyetjeve dhe ii) Komisionin Administrues të Testimit. Në këtë mënyrë u realizua Testimi i parëSeleksionues për gjyqtarë në gjykatën administrative të shkallës së parë dhe të gjykatës administrative të apelit, në datat 25-26 Mars 2013<sup>18</sup>.

Në testimin e parë për gjyqtarë në Gjykatën Administrative të Apelit më 25 Mars 2013<sup>19</sup> morën pjesë 43 kandidatë, nga të cilët 40 kandidatë kaluan pragun e pikëve maksimale të parashikuar nga ligji, mbi 70 pikë<sup>20</sup>. Ndërsa nëtestimin për gjyqtarë në Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë, më 26 Mars 2013, morën pjesë39 kandidatëdhe të gjithë kandidatët kaluan pragun e 70 pikëve.

Mosplotësimi i numrit të gjyqtarëve në disa prej gjykatave administrative të shkallës së parë, ndikoi në marrjen e masave prej KLD-së për të organizuar një testim seleksionues të dytë,<sup>21</sup> i cili u zhvillua më 3 shkurt 2014. Në këtë testim u paraqit vetëm një kandidat, që kaloi pragun e 70 pikëve dhe që u emërua në vijim. Ky fakt është tregues domethënës i interesit të ulët të gjyqtarëve për t’u emëruar në gjykatat administrative që nuk ushtrojnë veprimtarinë me seli në Tiranë.

Duhet evidentuar se në nenin 6 të Shtojcës së LGJA“Për organizimin e testimit kualifikues për emërimin e gjyqtarëve administrativë të shkallës së parë dhe të apelit”, parashikon se “...në rast se numri i kandidatëve fitues, nga testimi seleksionues është më i madh se numri i gjyqtarëve të emëruar, kandidatët e tjerë mbahen në një listë pritjeje, pa qenë e nevojshme kryerja e një testimi tjetër seleksionues, në rastet e krijimit të një vendi vakant, Listë pritje e cila vlen për një periudhë jo më të gjatë se 3-vjeçare.”. Aktualisht, nga lista e 40 kandidatëve fitues të testimit seleksionues për në Gjykatën Administrative të Apelit mbeten kandidatë në listë pritje 33 gjyqtarë, pasi 7 prej tyre janë emëruar në Gjykatën Administrative të Apelit. Megjithatë, duhet evidentuar gjithashtu, se edhe 10 gjyqtarë të tjerë të 40 kandidatëve fitues janë emëruar gjyqtarë administrativë në shkallën e parë për shkak të pjesëmarrjes së suksesshme të tyre edhe në testimin kualifikues për gjykatat administrative të shkallës së parë. Ndërsa 1 kandidate fituese,

<sup>18</sup>Shihvendimin nr. 305 datë 08.03.2013 “Mbi kaktimin e datave të zhvillimit të testimit seleksionues për gjyqtarë në gjykatat administrative të shkallës së parë dhe të apelit”. Korrigjimi i rezultateve të testimit u krye për herë të parë me metodën elektronike scan tron, që dha mundësinë e korrigjimit efektiv dhe transparent, brenda disa minutave nga përfundimi i testimit dhe në prani të vetë gjyqtarëve që konkuruan dhe të monitoruesve të akredituar.

<sup>19</sup>Shih procesverbalin e datës 22.04.2013 të Komisionit të Administrimit të Testimit të gjyqtarëve për Gjykatën Administrative të Apelit dhe të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë

<sup>20</sup>Në nenin 6 të Shtojcës sëLGJA përcaktohet: “Konsiderohen që kanë kaluar me sukses testimin seleksionues kandidatët që marrin jo më pak se 70 për qind të totalit të pikëve”

<sup>21</sup>Shih vendimin nr.407 datë 16.12.2013 KLD.

me leje të KLD-së, është rekrutuar në strukturat juridiko-profesionale tëMD-së<sup>22</sup> bazuar në nenin 28 pika 1 të ligjit nr. 9877/2008. Lista e pritjes me 22 kandidatë mbetet e vlefshme deri më25 Mars 2016.

Këto të dhëna konfirmojnë që kërkesat nga gjyqtarët për vendet vakante në gjykata administrative është i ulët. Kjo situatë shpjegohet se gjyqtarët përgjithësisht synojnë gjykatat me seli në Tiranë, të cilat janë më atraktive në raport me gjykatat e tjera. Nga ana tjetër, pozicioni i gjyqtarit administrativ ndonëse fitohet me një procedurë konkurruese të fortë, bazuar në kriteret shtesë krahasuar me gjyqtarin e juridiksionit të zakonshëm, nuk shoqërohet me elemente nxitëse për gjyqtarin si në drejtim të pagës ashtu edhe në atë tëkarrierës profesionale, apo në çështje të tjera.

Për qëllime të këtij studimi u analizuan edhe mungesat afatgjata të gjyqtarëve në detyrë. Sipas vendimit nr.138/3, datë 19.03.2003 të KLD-së, lejet afatmesme apo afatgjata të gjyqtarëve jepen me vendim të KLD-së, ndërsa lejet afatshkurtra jepen nga kryetari i Gjykatës dhe Zëvendëskryetari i KLD-së (në varësi të ditëve të lejes). Nga fillimi i funksionimit të gjykatave administrative, rezulton se Kryetari i Gjykatës Administrative të Apelit ka marrë 2 herë leje afatshkurtra 3 dhe 5 ditore, për arsye familjare dhe për trajnim. Shkëputja afatshkurtër e tij nuk mund të thuhet se ka ndikuar në efikasitetin e gjykatës. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndonëse organika është me 16 gjyqtarë, efektivisht kanë ushtruar detyrën 15 gjyqtarë. Një gjyqtare ka qenë me leje lindje për periudhën 04.11.2013-20.10.2014, pas përfundimit të të cilës ka marrë dhe leje vjetore, në periudhën 20.10.2014-20.11.2014, ndërsa në vijim 1 gjyqtare tjetër ka marrë leje afatgjatë nga KLD për qëllime studimi për një periudhë tre vjeçare, duke filluar nga 1 janari 2015<sup>23</sup>. Në gjykatat e tjera administrative nuk ka patur mungesa të gjyqtarëve në detyrë.

Po ashtu, prej kryetarëve të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë është ngritur vijimisht problemi i plotësimit të organikës me numrin përkatës të gjyqtarëve.

## 2.4. Ndhmësit ligjorë

Një prej çështjeve, që është identifikuar me lidhje të drejtpërdrejtë me ndikim në efikasitetin e gjykatave administrative është ajo e ndihmësve ligjorë. Sot, ndihmësit ligjorë ende nuk janë emëruar për shkak se kuadri ligjor për procedurat e rekrutimit të tyre është vlerësuar i

<sup>22</sup>Me vendimin nr.411 datë 16.12.2013 “Për dhënien e pëlqimit, zj. Alma Hicka, për të shërbyer si avokate e përgjithshme e shtetit”

<sup>23</sup> Vendim nr.147 datë 05.12.2014 “Mbi dhënien e lejes për arsye studimi gjyqtares Afërdita Maho, gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”



paplotë. Kryetarët e gjykatave administrative, në raportin e tyre periodik, kanë ngritur vijimisht domosdoshmërinë e emërimit të ndihmësve ligjorë.

Ndryshimet e fundit me ligjin nr. 100/2014 kanë rregulluar statusin e ndihmësve ligjorë në gjykatat administrative. Në dhjetor 2014, Gjykata Kushtetuese mori në shqyrtim kërkesën mbi shfuqizimin si antikushtetues të dispozitave që parashikonte ligji nr. 100/2014, për mënyrën dhe procedurat e përzgjedhjes së ndihmësve ligjorë. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën<sup>24</sup> duke lënë në fuqi dispozitat ligjore.

Kështu ligji parashikon kushtet dhe procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve për ndihmës ligjorë pranë gjykatave administrative të shkallës së parë dhe Gjykatës së Apelit Administrativ, të tilla si:

- përcaktimi i numrit të ndihmësve ligjorë për çdo gjykatë administrative. Në çdo rast ky numër nuk mund të jetë më i vogël se 50% e numrit të gjyqtarëve të gjykatës dhe se gjyqtari i gjykatës administrative ka deri në dy ndihmës ligjorë;
- procesi i përzgjedhjes së ndihmësve ligjorë i nënshtrohet një procedure konkurruese rekrutimi, transparente dhe merite;
- rekrutimi i ndihmësve ligjorë pa iu nënshtuar procedurave të konkurrimit të kandidatëve qëkanë përfunduar studimet në Shkollën e Magjistraturës; apo që kanë punuar si gjyqtarë dhe nuk janë larguar nga sistemi për shkak të ndonjë mase disiplinore; apo qëkanë punuar si këshilltarë të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, me përvojë pune në këto pozicione jo më pak se 5 vjet;
- përcaktimi i procedurave të emërimit, lirimit dhe shkarkimit të ndihmësve ligjorë si dhe trajtimin e tyre me pagë. Ndihmësat ligjorë do të përfitojnë pagë në vlerën 75% të pagës së gjyqtarit të gjykatës pranë së cilës do të ushtrojë veprimtarinë;
- parashikimi i kushteve për emërim që duhet të plotësojnë ndihmësat ligjorë, ku parashikohet që të jenë të diplomuar si “Jurist” dhe të kenë përvojë profesionale mbi 5 vjet për ndihmësat ligjorë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe mbi 7 vjet në Gjykatën Administrative të Apelit;
- Përcaktimi i përbërjes, funksionimit dhe procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për ndihmësa ligjorë nga komisioni *ad hoc*.

Në zbatim të këtij ligji, MD hartoi projekturdrin “Për rregullat e organizimit dhe funksionimit të komisionit *ad hoc* për ndjekjen e procedurave të rekrutimit të ndihmësve ligjorë në gjykatat administrative” dhe projekturdrin “Për kriteret dhe procedurat e organizimit të testimit për pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat administrative”. Këto dy projektakte i janë përcjellë për

<sup>24</sup>Shih njoftimin publik të Gjykatës Kushtetuese të datës 15.01.2015, ([http://www.gjk.gov.al/web/Njoftime\\_te\\_vitit\\_2015](http://www.gjk.gov.al/web/Njoftime_te_vitit_2015))



mendim gjykatave administrative dhe për dijëni KLD-së<sup>25</sup>. Mbetet e pritshme që në përfundim të këtij procesi të bëhet i mundur emërimi i ndihmësve ligjorë në gjykatat administrative.

Ndërkohë që administrata e GjAA është e plotë, duke qenë në raport më të mirë krahasimisht me atë të Gjykatave të Apelit të juridiksionit të zakonshëm, si dhe me standardet evropiane.

## 2.5. Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë

Volumi i lartë i çështjeve të regjistruara në gjykatat administrative shpjegohet edhe me regjimin tranzitor të LGJA, i cili nuk përmbante dispozita për rregullimin e çështjeve administrative të regjistruara në gjykata përpara fillimit të funksionimit të gjykatave administrative, më 4 nëntor 2013. Praktika gjyqësore për këto çështje u njehsua nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 3/2013. Në këtë vendim, Gjykata e Lartë është shprehur se “...Gjykatat administrative të shkallës së parë, Gjykata e Apelit Administrativ dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, të krijuara me ligjin nr.49, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, janë kompetente për shqyrtimin e të gjitha çështjeve, të cilat sipas nenit 7 të këtij ligji përbëjnë mosmarrëveshje administrative, pavarësisht gjendjes, fazës apo shkallës së gjykimin. Këto gjykata janë kompetente për çështjet administrative për të cilat, padia, ankimi ose rekursi është depozituar përpara datës 04.11.2013, respektivisht në gjykatat e shkallës së parë, të apelit apo në Gjykatë të Lartë dhe deri në këtë datë, shqyrtimi në këto gjykata nuk ka përfunduar akoma...”.

Kryetarët e gjykatave administrative, në raportimin e tyre periodik mujor, kanë evidentuar si çështje problematike zbatimin e vendimit unifikues. Sipas tyre, për shkak të vendimit unifikues të gjitha çështjet administrative të ngritura para gjykatës së rretheve gjyqësore, ose të cilat shqyrtoheshin mbi bazë ankimi nga gjykatat e apeleve u kaluan përkatësisht në gjykatat administrative të shkallës së parë dhe apelit administrativ. Ky fakt ka ndikuar në volumin e lartë të çështjeve gjyqësore pranë këtyre gjykatave.

Ndonëse u kërkuan të dhëna pranë gjykata administrative të Tiranës mbi volumin e çështjeve të tilla të regjistruara pranë tyre, për qëllime të identifikimit të saktë të rolit të tyre në efikasitetin e gjykatave administrative, ky numër nuk u paraqit. Regjistrat që mbahen aktualisht në gjykata janë ende manualë dhe nuk mundësojnë tërheqjen e një statistike të tillë.

## 2.6. Çështje të tjera

- *Infrastruktura*

<sup>25</sup>Shih shkresën nr. 43 prot., datë 06.01.2015 të Ministrit të Drejtësisë

Krijimi i infrastrukturës së nevojshme për ushtrimin normal të veprimtarisë së gjykatave administrative është një detyrim ligjor që rrjedh nga LGJA dhe që ngarkon Këshillin e Ministrave për marrjen e masave për funksionimin e këtyre gjykatave. Gjithashtu, mirëfunksionimi i sistemit përmes investimeve në infrastrukturën e gjykatave dhe kushteve të punës ka qenë dhe vazhdon të jetë një nga prioritetet e qeverisë shqiptare që ndikon në reformimin e sistemit të drejtësisë. Për këtë qëllim, MD si institucion përgjegjës që kujdeset për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve që lidhen me sistemin gjyqësor, ka marrë masa të vazhdueshme për sigurimin e infrastrukturës, në funksion të plotësimit të një prej kriterëve të vënies në funksion të Gjykatës Administrative. Konkretisht:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë është akomoduar brenda ambienteve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë është akomoduar në dy kate të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër është akomoduar në dy kate të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë është akomoduar ambientet e katit të parë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është akomoduar në një godinë ekzistuese të rikonstruktuar tërësisht, e cila ndodhet në zonën e Laprakës “Rr. Don Bosko”, pranë Spitalit Ushtarak. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka 7 salla gjykimi, një ambient të veçantë për marrëdhëniet me publikun, arkivë, financa, kancelari dhe ambiente pune të përshtatshme për punonjësit e tjerë të administratës.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës fillimisht ka qenë e akomoduar brenda ambienteve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Në adresim të problematikave që kanë dalë gjatë funksionimit të kësaj gjykate, u ndërмор nisma për miratimin e VKM nr. 302, datë 21.5.2014 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 649, datë 8.10.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të një pjese të pronës nr. 17/16, me emërtim “Ish-drejtoria e Doganës, Durrës”, si dhe për një ndryshim në Vendimin nr. 586, datë 10.9.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listave të inventarëve të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat u kalojnë në përgjegjësi administrimi shoqërive anonime dhe ndërmarrjeve të sistemit të transportit detar dhe ajror”, qëllimi i të cilit është sigurimi i ambienteve të nevojshme për funksionimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Aktualisht, kjo gjykatë ushtron funksionin në ambientet e reja të rikonstruktura.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë aktualisht është akomoduar në territorin ekzistues të Gjykatës së Apelit Tiranë, në ambientet e ish - godinës së Gjykatës Ushtarake të Apelit. Nga rikonstruksioni i kësaj godine është bërë i mundshëm krijimi i hapësirave të nevojshme për akomodimin e 7 gjyqtarëve të kësaj gjykate, si dhe krijimi i ambienteve për publikun dhe pjesën tjetër të administratës. Në adresim të problematikave të dala gjatë funksionimit të kësaj gjykate, u ndërmor nisma për miratimin e VKM-së nr. 646, datë 1.10.2014 “Për kalimin e pronës së paluajtshme shtetërore, me emërtimin "Ish-Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme, Tiranë", në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 834, datë 13.12.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Tiranë, të Qarkut të Tiranës", si dhe për një shtesë në vendimin nr. 1292, datë 24.9.2008, të Këshillit të Kinistrave, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të trojeve dhe ndërtesave të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të gjykatave të apelit", të ndryshuar”. Ky vendim mundëson kalimin në përgjegjësi administrimi të MD të ambienteve të ish drejtorisë së konvikteve të shkollave të mesme, Tiranë, në funksion të akomodimit të Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë.

Gjithsesi, ka ende vend për përmirësimin e infrastrukturës. Ky konkluzion bazohet në faktin se kryetarët e gjykatave, në raportimet periodike e kanë evidentuar si shqetësim.

○ **Dixhitalizimi**

Në Republikën e Shqipërisë funksionojnë dy sisteme elektronike për proceset gjyqësore: sistemi elektronik për menaxhimin e çështjeve gjyqësore (ICMIS) dhe sistemi i regjistrimit dixhital audio të seancave gjyqësore (RDA).

Në muajin dhjetor 2014 përfundoi instalimi i sistemit ICMIS në gjykatat administrative, i cili paralelisht me trajnimin e stafit, është funksional. Ndërkohë qëmbetet e pritshme që në periudhën mars – maj 2015 të instalohet edhe sistemi RDA në këto gjykata. Lidhur me instalimin e sistemit të regjistrimit të seancave gjyqësore me sistemin audio, sipas projektit Just të USAID-it, kalendari paraqitet si më poshtë:

| Gjykatat Administrative | Periudha                  |          |
|-------------------------|---------------------------|----------|
|                         | Instalimi dhe Konfigurimi | Trajnimi |
| Apeli                   | Mars 15                   | Mars 15  |
| Tiranë                  | Mars 15                   | Prill 15 |

2015

|             |          |          |
|-------------|----------|----------|
| Durrës      | Prill 15 | Prill 15 |
| Gjirokastrë | Prill 15 | Prill 15 |
| Vlorë       | Prill 15 | Prill 15 |
| Korçë       | Maj 15   | Maj 15   |
| Shkodër     | Maj 15   | Maj      |

○ **Trajnimet**

Shkolla e Magjistraturës është organi i ngarkuar me ligj për sigurimin e formimit profesional të kandidatëve për magjistratë dhe të gjyqtarëve e prokurorëve në detyrë. Kështu, sipas nenit 23 të ligjit nr. 8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, gjyqtarët dhe prokurorët e gjykatave e të prokurorive të shkallës së parë dhe të gjykatave të apeleve i nënshtrohen formimit vazhdues. Periudha e formimit vazhdues nuk duhet të kalojë më shumë se 20 ditë në vit dhe jo më shumë se 60 ditë gjatë pesë vjetëve.

Nga fillimi i funksionimit të gjykatave administrative, SHM ka organizuar 10 sesione trajnuese për gjyqtarë të gjykatave administrative sipas programit të tematik të aktiviteteve të planifikuara për vitet akademike 2013 – 2014<sup>26</sup>.

Problem përbën mungesa e trajnimit të administratës gjyqësore të këtyre gjykatave (por edhe të gjykatave të tjera). Nga MD<sup>27</sup> i është sugjeruar SHM përfshirja në kurrikulat e programit tematik për pjesën e mbetur të vitit akademik 2014 – 2015, të trajnimit të administratës gjyqësore, me fokus të veçantë trajnimin e stafit të gjykatave administrative: kancelarë; kryesekretarë; sekretarë gjyqësorë dhe nëpunës gjyqësor, me qëllim rritjen e aftësive profesionale të këtyre punonjësve. Në këtë kuadër është sugjeruar parashikimi i temave të posaçme për trajnimin e personelit, për çështje që lidhen me veprimtarinë procedurale dhe administrative në zyrat e gjykatave, etikën, marrëdhëniet me median dhe publikun.

Gjithashtu, në adresim edhe të angazhimeve të ndërmarra nga institucionet shqiptare në kuadër të përmbushjes së 5 prioritetëve kyçe të Komisionit Evropian lidhur me zbatimin e reformës në administratën publike<sup>28</sup>, është parashikuar si masë e posaçme në udhërrëfyes trajnimi i personelit të gjykatave administrative (gjyqtarët dhe administrata gjyqësore). Gjithashtu, duke marrë në konsideratë zhvillimet e fundit të legjislacionit për nëpunësin dhe administratën publike, me

<sup>26</sup>Shih Aneks 2

<sup>27</sup>Shih shkresë nr. prot. 9006, datë 04.12.2014, të Ministrisë të Drejtësisë

<sup>28</sup>Shih VKM nr. 330, datë 28.5.2014 “Për miratimin e udhërrëfyesit për 5 prioritetet e rekomanduara nga Komisioni Evropian, 2013”, Prioriteti nr. 1 “Të vijohet zbatimi i reformës në administratën publike me qëllim rritjen e profesionalizmit dhe depolitizimin e administratës publike”

kërkesë të Departamentit të Administratës Publike, MD<sup>29</sup> i ka sugjeruar SHM të përfshijë në kurrikulat e saj të trajnimit për gjyqtarët e gjykatave administrative edhe tema që lidhen me zbatimin e parashikimeve të kuadrit të ri ligjor për administratën publike (ligji nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore të kësaj fushe), kjo me qëllim rritjen e efektivitetit në mbrojtjen e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve të nëpunësve të administratës publike.

---

<sup>29</sup>Shih shkresën nr. prot. 9244, datë 15.12.2014, të Ministrit të Drejtësisë

### 3. REKOMANDIME

Rekomandimet e dhëna në përfundim të këtij studimi mbështeten në nevojën për përmirësimin e situatës aktuale të gjykatës administrative të apelit. Kjo nismë synon të garantojë aspektet e nevojshme për përmirësimin e efikasitetit dhe profesionalizmit të gjykatave administrative në funksion të procesit të rregullt ligjor.

Për garantimin e rritjes së efektivitetit të gjykimit të proceve gjyqësore në gjykatën administrative të apelit dhe duke pasur parasysh të dhënat në lidhje me gjyqtarët në organikë dhe të dhënat lidhur me ngarkesën individuale të gjyqtarëve, do të ishte me vend që të ndryshohet situata në këtë gjykatë. Ky synim mund të realizohet nëpërmjet adresimit të rekomandimeve të mëposhtme:

**Rekomandim 1.** Rishikimi i numrit të gjyqtarëve në gjykatën administrative të apelit, duke sugjeruar shtesën prej 6 gjyqtarë në formatin e dy trupave gjykues me nga tre gjyqtarë. Ky numër është përcaktuar duke mbajtur në konsideratë analizën e këtij studimi, raportin e gjyqtarëve, volumin dhe efektet financiare. Nuk duhet harruar as fakti që volumi fillestar i gjykatave administrative nuk pasqyron një gjendje statike dhe pritet të ndryshojë për shkak të disa faktorëve si: (i) kalimi i periudhës tranzitore, si pasojë e të cilës në gjykatat administrative kaluan *en block* një numër i lartë çështjesh ekzistuese, gjykimi i të cilave filloi nga e para; (ii) fillimi i funksionimit të tyre menjëherë pas zgjedhjeve të përgjithshme në Republikën e Shqipërisë dhe pas hyrjes në fuqi të reformës së nëpunësit civil; (iii) konsolidimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve dhe unifikimi i praktikës gjyqësore; (iv) përmirësimi i kushteve të punës. Zbatimi i këtij rekomandimi kërkon rishikimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 7818/2012 dhe zbatimin e efikas të tij duke përdorur rezultatet e listës së pritjes.

Në kuadër të këtij rekomandimi mbetet për t'u adresuar edhe çështja aktuale për gjykimin e 3700 çështjeve gjyqësore, për të cilat është kërkuar delegimi i gjyqtarëve nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë. Në këtë drejtim, nëse nga KLD vlerësohet se rishikimi i numrit të gjyqtarëve mund të zgjasë në kohë, atëherë lidhur me këto çështje mund të vijojë praktika e delegimit të gjyqtarëve.

**Rekomandimi 2.** Emërimi në një kohë sa më të shpejtë të ndihmësve ligjorë në gjykatat administrative, të cilët pritet të përshpejtojnë gjykimin dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore në kohën e duhur. Zbatimi i këtij rekomandimi kërkon finalizimin e akteve nënligjore të Ministrisë së Drejtësisë dhe zbatimin e menjëhershëm të tyre.

**Rekomandimi 3.** Plotësimi organikës me numrin përkatës të gjyqtarëve në gjykatat administrative të shkallës së parë Gjyrokastër, Korçë, Shkodër dhe Vlorë. Ky rekomandim është

më i vështirë për t'u zbatuar pasi kërkon ndërhyrje ligjore në prezantimin e mjeteve nxitës për gjyqtarët që emërohen në këto gjykata, për shkak të interesit të ulët që kanë dëshmuar gjyqtarët në kushtet aktuale.

**Rekomandimi 4.** Përditësimi i standardeve matëse të veprimtarisë gjyqësore, që lidhen me gjykatat administrative për efekte të vlerësimit profesional. Ky rekomandim duhet zbatuar nga KLD dhe duhet të përqaset në të njëjtën kohë me finalizimin e nismës për reformimin e sistemit të vlerësimit të gjyqtarëve, që është ndërmarrë nga Ministria e Drejtësisë.

**Rekomandimi 5.** Përmirësimi në vazhdimësi dhe me një platformë të qartë të numrit të administratës gjyqësore. Në kushtet kur kjo reformë ka ndikim financiar, zbatimi i saj kërkon marrjen e masave të kujdesshme nga ZABGj në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë.

**Rekomandimi 6.** Përmirësimi i mëtejshëm i infrastrukturës dhe pajisjeve në gjykatat administrative, duke mundësuar përdorimin eficient edhe të sistemeve elektronike të menaxhimit të çështjeve dhe të regjistrimit audio të seancave. Gjithashtu, rekomandohet të fillojë sa më shpejt funksionimi i faqeve zyrtare të internetit të këtyre gjykatave. Zbatimi i këtij rekomandimi kërkon marrjen e masave të kujdesshme nga ZABGj në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë.

**Rekomandimi 7.** Përmirësimi i regjistrave për nxjerrjen e të dhënave, sidomos për çështjet e zvarritura. Zbatimi i këtij rekomandimi kërkon marrjen e masave nga ana e kryetarëve, kancelarëve në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë.

**Rekomandimi 8.** Intensifikimi i bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës për të siguruar një sistem të qëndrueshëm trajnimi për gjyqtarët dhe administratën gjyqësore, në raport me nevojat praktike të veprimtarisë së tyre. Zbatimi i këtij rekomandimi kërkon marrjen e masave nga ana e Shkollës së Magjistraturës për të bërë të mundur përfshirjen në kurrikulat e trajnimit të administratës gjyqësore, në bashkëpunim me kryetarët e gjykatave dhe me Ministrinë e Drejtësisë.

**Rekomandimi 9.** Përfshirjen e çështjes së emërimit të kryetarëve të gjykatave administrative të shkallës së parë Durrës, Shkodër, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë sa më shpejt në rendin e ditës të mbledhjeve të KLD-së. Ky rekomandim zbatohet drejtpërdrejt nga KLD.

**ANEKS 1 - Të dhënat statistikore**

**Statistikat për periudhën 4 nëntor 2013 – 31 Dhjetor 2013**

- Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë

| Gjykata      | Çështjet gjyqësore |               |              |
|--------------|--------------------|---------------|--------------|
|              | Të regjistruara    | Të shqyrtuara | Të ankimuara |
| Durrës       | 254                | 39            | 1            |
| Gjirokastrë  | 63                 | 34            | 9            |
| Korçë        | 73                 | 18            | 7            |
| Shkodër      | 168                | 28            | 4            |
| Vlorë        | 317                | 192           | 41           |
| Tiranë       | 802                | 98            | 0            |
| <b>Total</b> | <b>1677</b>        | <b>409</b>    | <b>45</b>    |

- Gjykata Administrative e Apelit

| Gjykata | Çështjet gjyqësore |               |
|---------|--------------------|---------------|
|         | Të regjistruara    | Të shqyrtuara |
| Tiranë  | 68                 | 54            |

**Statistikat për periudhën Janar – Dhjetor 2014**

**3 muji I**

- Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë

| Gjykata     | Çështjet gjyqësore |               |              |
|-------------|--------------------|---------------|--------------|
|             | Të regjistruara    | Të shqyrtuara | Të ankimuara |
| Durrës      | 996                | 373           | 156          |
| Gjirokastrë | 435                | 320           | 108          |



Studim vlerësues

Ngarkesa e punës në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë

2015

|                |             |             |             |
|----------------|-------------|-------------|-------------|
| <b>Korçë</b>   | 306         | 151         | 79          |
| <b>Shkodër</b> | 616         | 207         | 66          |
| <b>Vlorë</b>   | 842         | 383         | 147         |
| <b>Tiranë</b>  | 4368        | 1668        | 940         |
| <b>Total</b>   | <b>7563</b> | <b>3102</b> | <b>1496</b> |

- Gjykata Administrative e Apelit

| Gjykata       | Çështjet gjyqësore |               |
|---------------|--------------------|---------------|
|               | Të regjistruara    | Të shqyrtuara |
| <b>Tiranë</b> | <b>2108</b>        | <b>1151</b>   |

**3 mujori II**

- Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë

| Gjykata            | Çështjet gjyqësore |               |              |
|--------------------|--------------------|---------------|--------------|
|                    | Të regjistruara    | Të shqyrtuara | Të ankimuara |
| <b>Durrës</b>      | 1274               | 1012          | 644          |
| <b>Gjirokastrë</b> | 1338               | 1229          | 172          |
| <b>Korçë</b>       | 2180               | 1612          | 319          |
| <b>Shkodër</b>     | 827                | 222           | 140          |
| <b>Vlorë</b>       | 1096               | 658           | 440          |
| <b>Tiranë</b>      | 5315               | 2805          | 1997         |
| <b>Total</b>       | <b>12030</b>       | <b>7538</b>   | <b>3712</b>  |

- Gjykata Administrative e Apelit

| Gjykata | Çështjet gjyqësore |               |
|---------|--------------------|---------------|
|         | Të regjistruara    | Të shqyrtuara |

|               |             |             |
|---------------|-------------|-------------|
| <b>Tiranë</b> | <b>4477</b> | <b>1452</b> |
|---------------|-------------|-------------|

### 3 mujori III

- Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë

| Gjykata       | Çështjet gjyqësore |               |              |
|---------------|--------------------|---------------|--------------|
|               | Të regjistruara    | Të shqyrtuara | Të ankimuara |
| Durrës        | 1239               | 971           | 644          |
| Gjirokastrë   | 1032               | 903           | 81           |
| Korçë         | 400                | 140           | 87           |
| Shkodër       | 1069               | 185           | 168          |
| Vlorë         | 937                | 554           | 290          |
| <b>Tiranë</b> | <b>4533</b>        | <b>1544</b>   | <b>2748</b>  |
| <b>Total</b>  | <b>9210</b>        | <b>4297</b>   | <b>4018</b>  |

- Gjykata Administrative e Apelit

| Gjykata       | Çështjet gjyqësore |               |
|---------------|--------------------|---------------|
|               | Të regjistruara    | Të shqyrtuara |
| <b>Tiranë</b> | <b>4963</b>        | <b>987</b>    |

### 3 mujori IV

- Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë

| Gjykata     | Çështjet gjyqësore |               |              |
|-------------|--------------------|---------------|--------------|
|             | Të regjistruara    | Të shqyrtuara | Të ankimuara |
| Durrës      | 664                | 302           | 297          |
| Gjirokastrë | 689                | 625           | 129          |

|                |             |             |             |
|----------------|-------------|-------------|-------------|
| <b>Korçë</b>   | 550         | 337         | 153         |
| <b>Shkodër</b> | 1208        | 312         | 207         |
| <b>Vlorë</b>   | 443         | 517         | 210         |
| <b>Tiranë</b>  | 4201        | 2570        | 2400        |
| <b>Total</b>   | <b>7755</b> | <b>4663</b> | <b>3396</b> |

- Gjykata Administrative e Apelit

| Gjykata       | Çështjet gjyqësore |               |
|---------------|--------------------|---------------|
|               | Të regjistruara    | Të shqyrtuara |
| <b>Tiranë</b> | <b>7373</b>        | <b>1021</b>   |

#### Ngarkesa individuale e gjyqtarëve

Për periudhën 4 nëntor 2013 – 31 Dhjetor 2013

- Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë

| Gjykata                    | Ngarkesa individuale |               |
|----------------------------|----------------------|---------------|
|                            | Të regjistruara      | Të shqyrtuara |
| <b>Durrës<sup>30</sup></b> | 83                   | 13            |
| <b>Gjirokastrë</b>         | 32                   | 17            |
| <b>Korçë</b>               | 37                   | 9             |
| <b>Shkodër</b>             | 84                   | 14            |
| <b>Vlorë<sup>31</sup></b>  | 159                  | 96            |
| <b>Tiranë</b>              | 50                   | 6             |

- Gjykata Administrative e Apelit

<sup>30</sup>Të dhënat janë pjesëtuar me numrin e gjyqtarëve për këtë periudhë = 3 gjyqtarë

<sup>31</sup>Të dhënat janë pjesëtuar me numrin e gjyqtarëve për këtë periudhë = 2 gjyqtarë

| Gjykata       | Ngarkesa individuale |               |
|---------------|----------------------|---------------|
|               | Të regjistruara      | Të shqyrtuara |
| <b>Tiranë</b> | <b>10</b>            | <b>8</b>      |

**Për periudhën Janar – Dhjetor 2014**

- Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë

| Gjykata                         | Ngarkesa individuale |               |
|---------------------------------|----------------------|---------------|
|                                 | Të regjistruara      | Të shqyrtuara |
| <b>Durrës<sup>32</sup></b>      | 1043                 | 665           |
| <b>Gjirokastrë<sup>33</sup></b> | 1747                 | 1539          |
| <b>Korçë<sup>34</sup></b>       | 1718                 | 1120          |
| <b>Shkodër<sup>35</sup></b>     | 1860                 | 463           |
| <b>Vlorë<sup>36</sup></b>       | 1106                 | 704           |
| <b>Tiranë<sup>37</sup></b>      | 1151                 | 533           |

- Gjykata Administrative e Apelit

| Gjykata       | Çështjet gjyqësore |               |
|---------------|--------------------|---------------|
|               | Të regjistruara    | Të shqyrtuara |
| <b>Tiranë</b> | <b>2703</b>        | <b>659</b>    |

**Të dhëna statistikore krahasimore**

<sup>32</sup> Të dhënat janë pjesëtuar me numrin e gjyqtarëve = 4 gjyqtarë  
<sup>33</sup> Të dhënat janë pjesëtuar me numrin e gjyqtarëve = 2 gjyqtarë  
<sup>34</sup> Të dhënat janë pjesëtuar me numrin e gjyqtarëve = 2 gjyqtarë  
<sup>35</sup> Të dhënat janë pjesëtuar me numrin e gjyqtarëve = 2 gjyqtarë  
<sup>36</sup> Të dhënat janë pjesëtuar me numrin e gjyqtarëve = 3 gjyqtarë  
<sup>37</sup> Të dhënat janë pjesëtuar me numrin e gjyqtarëve = 16 gjyqtarë

Raporti i çështjeve civile dhe atyre administrative në gjykatat respektive të apelit Tiranë

Për vitin 2013, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë (çështje civile):

- janë regjistruar 15.890 çështje
- janë shqyrtuar 6.589 çështje.

Për 9-mujorin e parë të vitit 2014 (janar – shtator) rezultojnë të dhënat e mëposhtme:

| Gjykatat                                | Çështjet gjyqësore |               | Ngarkesa individuale e gjyqtarëve |               |
|---|--------------------|---------------|-----------------------------------|---------------|
|   | Të regjistruara    | Të shqyrtuara | Të regjistruara                   | Të shqyrtuara |
| <b>Apeli (civile)<sup>38</sup></b>      | 11. 446            | 3.250         | 440                               | 125           |
| <b>Apeli Administrativ<sup>39</sup></b> | 11.548             | 3.590         | 1.650                             | 513           |

**Statistika mbi çështjet me objekt marrëdhëniet e punës – statusi i nëpunësit civil;**

- Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë

| Gjykata            | Çështjet gjyqësore |               |
|--------------------|--------------------|---------------|
|                    | Të regjistruara    | Të shqyrtuara |
| <b>Durrës</b>      | 163                | 163           |
| <b>Gjirokastrë</b> | 41                 | 41            |
| <b>Korçë</b>       | 100                | 99            |
| <b>Shkodër</b>     | 26                 | 9             |
| <b>Vlorë</b>       | 35                 | 35            |
| <b>Tiranë</b>      | 166                | 112           |
| <b>Total</b>       | <b>531</b>         | <b>459</b>    |

Nga të dhënat e përcjella nga gjykatat administrative të shkallës së parë, rezulton se rreth 85 – 90% e çështjeve gjyqësore janë ankimuar.

<sup>38</sup> Mesatarja e ngarkesës është llogaritur për 26 gjyqtarë

<sup>39</sup> Mesatarja e ngarkesës është llogaritur për 7 gjyqtarë

**Të dhënat statistikore të Kolegjit Administrativ në Gjykatën e Lartë janar-nëntor 2014**

| Nr. | Lloji i çështjeve | Administrative |
|-----|-------------------|----------------|
|     | Gjendja           |                |
| 1.  | Mbartur           | 4819           |
| 2.  | Ardhur            | 2002           |
| 3.  | <b>Gjithsej</b>   | <b>6821</b>    |
| 4.  | Gjykuar           | 1599           |
| 5.  | Në dorë           | 5222           |

**ANEKS 2 – Trajnimet**

**Trajnime të zhvilluara dhe të planifikuara 2013 - 2014**

|    |                     |  |
|----|---------------------|--|
| 1. | 21 nëntor<br>2013   | Zbatimi i Sistemit të Drejtësisë Administrative në Shqipëri.   |
| 2. | 22 nëntor<br>2013   | Zbatimi i Sistemit të Drejtësisë Administrative në Shqipëri.   |
| 3. | 23 dhjetor<br>2013  | Gjykimi, në seancë gjyqësore, të padisë administrative, në kuadrin e ligjit Nr.49/2012, si gjykim i posaçëm. Rregullat ligjore të zbatueshme gjatë gjykimit ( <b>Kodi i Proçedures Civile dhe ligji organik Nr.49/2012</b> ) dhe ndërthurja midis tyre. Si gjejnë zbatim në gjykimin administrativ institutet e gjykimit civil, si psh. ndërthurja në gjykim të personave të tretë, shtimi apo pakësimi i objektit të padisë dhe ndryshimi i shkakut ligjor, paditë e përziera, barra e të provuarit dhe parimi i detyrimit të Gjykatës për hetim të plotë e të gjithanshëm, etj.  |
| 4. | 24 dhjetor<br>2013  | Vendimi gjyqësor administrativ si titull ekzekutiv si dhe detyrat e Gjykatës administrative gjatë ekzekutimit të tij. Rregullat ligjore të zbatueshme gjatë gjykimit ( <b>Kodi i Proçedures Civile dhe ligji organik Nr.49/2012</b> ) dhe ndërthurja midis tyre.   |
| 5. | 24 janar 2014       | Antitrust (praktika gjyqësore):<br>a) Eksperiencia shqiptare në lidhje me: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Abuzimin me pozitën dominuese (rastet e telefonisë së lëvizshme, në tregun e prodhimit në vend të hidrokarbureve);</li> <li>• Marrëveshjet e ndaluara apo kartelet (rastet tregu I sigurimeve, tregu i importit të grurit dhe I prodhimit të miellit).</li> </ul> b) Eksperiencia evropiane <ul style="list-style-type: none"> <li>• Abuzimi me pozitën dominuese rasti i Microsoft;</li> <li>• Kartelet.</li> </ul> Kontrolli i përqëndrimeve (praktika gjyqësore):<br>a) Eksperiencia shqiptare (vendimet e Komisionit të Konkurrencës);<br>b) Eksperiencia evropiane. |
| 6. | 22-23 prill<br>2014 | Problematika që përcillet në gjyqësorin shqiptar në lidhje me legjislacionin në fushën e prokurimit publik. <ul style="list-style-type: none"> <li>• Parimet në procesin e prokurimit publik.</li> <li>• Cikli i procesit të prokurimit publik.</li> <li>• Kriteret e kualifikimit dhe përcaktimit të ofertës fituese.</li> <li>• Kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose fituesve;</li> <li>• Kompetencat e APP në përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga e drejta për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit;</li> <li>• Procedura administrative e përjashtimit.</li> <li>• Procesi i rishikimit të vendimeve të Autoriteteve Kontraktore</li> </ul>                              |
| 7. | 4-6 qershor<br>2014 | E drejta administrative.   |

**Trajnimet më të fundit**

|    |                   |   |
|----|-------------------|---|
| 1. | 14 nëntor<br>2014 | Legjislacioni tatimor dhe prokurimet.   |
| 2. | 21 nëntor<br>2014 | Legjislacioni tatimor dhe prokurimet.   |
| 3. | 30 janar<br>2015  | Problematika që përcillet në gjyqësorin shqiptar në lidhje me legjislacionin në fushën e tatimeve. <ul style="list-style-type: none"><li>• Aspektet ligjore.</li><li>• Aspektet praktike, jurisprudenca e GjL-së.</li></ul> |



### ANEKS3 –Kontaktet e gjykatave administrative

#### 1. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Kryetar: Gjyqtari Kastriot Selita  
Kancelar: Leonard Strataj  
Adresa: Bulevardi “Zhan D’Ark”, 1001, Tiranë  
Telefon: 042251151  
Tel/Faks: -

#### 2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë

Kryetar: Gjyqtari Eriol Roshi  
Kancelar: Lertida Balili  
Adresa: Rruga “Don Bosko”, 1001, Tiranë  
Telefon: 042447088  
Tel/Faks: -

#### 3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë

Kryetar: Gjyqtari Sokol Ibi  
Kancelar: Aleksandër Dino  
Adresa: Rruga “Nënë Tereza”, Lagjja nr. 3, Korçë  
Telefon: 08224 3119  
Tel/Faks: 08224 2725

#### 4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës

Kryetar: Gjyqtari Genci Sinjari  
Kancelar: Elona Hysi  
Adresa: Sheshi “Mujo Ulqinaku” (pranë ish-zyrave të përmbarimit, në hyrje të Portit të Durrësit), Durrës  
Telefon: -  
Tel/Faks: -

#### 5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë

Kryetar: Gjyqtari Astrit SHEME  
Kancelar: Taviola Myftari  
Adresa: Lagjia “Hajro Çakërri”, Rruga “Sulejman Delvina”, Vlorë  
Telefon: 033408046/033408047  
Tel/Faks: -

#### 6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë

Kryetar: Gjyqtari Ramiz Lala

Kancelar: Dhurata Abazi  
Adresa: Lagjia “18 Shtatori”, Gjirokastrë  
Telefon: 08426 2292  
Tel/Faks: -

**7. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër**

Kryetar: Gjyqtarja Valbona Durraj  
Kancelar: Blerta Nurja  
Adresa: Lagjia “Qemal Stafa”, Rruga “Don Bosko”, Shkodër  
Telefon: 022212121  
Tel/Faks: 022212122